



Prishtinë, 15.10.2018
Kodi i ZRRE-së: V_1061_2018

Bordi i Zyrës së Rregullatorit për Energji,

Bazuar në:

- Dispozitat e Neneve 15 dhe 26 të Ligjit për Rregullatorin e Energjisë,
- Dispozitat e Nenit 16 të Rregullës për Licencimin e Aktiviteteve të Energjisë në Kosovë,
- Dispozitat e Nenit 7 të Licencës së Operatorit të Sistemit të Transmetimit,
- Kërkesën e KQKO për amandamentimin e Kodit të Rrjetit – Kodi i Kycjes të datës 03 gusht 2018,

në seancën e mbajtur me datë 15.10.2018, nxori këtë:

VENDIM

- I. **APROVOHET** versioni i ri i dokumentit “Kodi i Rrjetit - Kodi i Kycjes” të KOSTT Sh.a., si në shtojcë të këtij vendimi.

Arsyetim

- o Zyra e Rregullatorit për Energji (ZRRE) me datë 04.10.2017 ka pranuar kërkesën e KQKO për amandamentimin e dokumentit “Kodi i Rrjetit – Kodi i Kycjes” të harmonizuar me legjislacionin në fuqi. Në këtë kuadër janë shtuar disa pika si edhe është bërë përshtatja e termave sipas legjislacionit në fuqi, përmirësime gjuhësore dhe rregullime të tekstit.
- o ZRRE ka dhënë komente gjatë shqyrtimit të dokumentit si pjesëmarrëse aktive në KQKO, gjithashtu ZRRE ka dhënë komente edhe pas dërgimit të dokumentit për aprovim në ZRRE, të cilat komente janë përfshirë në dokument. Në ndërkohë është paraqitur kërkesa për ndryshim më të zgjeruar të Kodit të Rrjetit – Kodi i Kycjes, si kërkesë e Komunitetit të Energjisë për përfshirjen në dokument të dispozitave të kodeve të rrjetit të UE (Requirements for Grid Connection of Generators dhe Demand Connection Network Code).
- o Pas përfshirjes së të gjitha komenteve dhe finalizimit të dokumentit, KQKO me datë 03.08.2018 ka dërguar versionin e ri të dokumentit “Kodi i Rrjetit – Kodi i Kycjes” në ZRRE me kërkesën për aprovimin e amandamentimit të tij.